



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2020

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.9062, DATË 8.5.2003,
“KODI I FAMILJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 53, 54, 81, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, si dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Neni 241 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 241
Kushtet e birësimit

Birësohet vetëm i mituri.

Ka të drejtë për të birësuar personi që ka mbushur moshën 21 vjeç dhe ka zotësi të plotë për të vepruar.

Birësuesi duhet të ketë një diferencë minimale moshe të paktën 18 vjet me të birësuarin, si dhe një diferencë maksimale moshe jo më shumë se 50 vjet.

Në rastin kur birësohet fëmija i bashkëshortit, diferenca e moshës duhet të jetë jo më pak se 15 vjet.

Kufizimet e përcaktuara në paragrafin 3, të këtij neni, mund të mos zbatohen në rastet kur Komiteti Shqiptar i Birësimeve dhe gjykata konstatojnë se:

- a) mosdhënia për birësim mund të shkaktojë dëme të rënda për të miturin dhe ky dëm nuk mund të shmanget në mënyrë tjetër;
- b) ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit është krijuar një marrëdhënie

- prindërore, para paraqitjes së kërkesës për birësim;
- c) kërkohet të birësohen disa vëllezër dhe motra dhe birësuesit përmbushin kushtin e diferencës së moshës vetëm për njërin prej tyre;
- ç) i mituri që birësohet është vëllai ose motra e një të mituri të birësuar nga të njëjtët birësues;
- d) kufiri maksimal i moshës së birësuesve tejkalohet vetëm nga njëri prej bashkëshortëve, në një masë jo më të madhe se 10 vjet;
- dh) birësuesit janë prindër të fëmijëve biologjikë apo të birësuar, nga të cilët të paktën njëri është i mitur.”.

Neni 2

Neni 242 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 242

I mituri mund të birësohet nga një person i vetëm ose nga persona që janë bashkëshortë ose bashkëjetues sipas përcaktimeve të nenit 163, të këtij Kodi, që kanë bashkëjetuar në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme për të paktën 3 vjet.

Birësuesi ka të drejtë të bëjë disa birësime, me akte të njëpasnjëshme. Birësuesit i jepet përparësi nëse ka birësuar vëllain ose motrën e të miturit që synohet të birësohet, nëse paraqet kërkesë për birësimin e motrave dhe vëllezërve të tjerë, ose nëse shfaq gatishmërinë për të birësuar të mitur që gjenden në kushte të vështira shëndetësore ose sociale.

Kanë të drejtë të birësojnë birësuesit që kanë fëmijë biologjikë.

Birësimi i ri i të miturit lejohet vetëm në këto raste:

- a) Pas vdekjes së birësuesit ose të birësuesve;
- b) Pas vdekjes së njërit prej birësuesve, në qoftë se kërkesa për birësim paraqitet nga bashkëshorti ose bashkëjetuesi i ri i birësuesit;
- c) Nëse i mituri është birësuar nga një person i vetëm dhe kërkesa për birësim paraqitet nga bashkëshorti ose bashkëjetuesi i tij;
- ç) Nëse birësimi i mëpasshëm është i justifikuar nga shkaqe me rëndësi, që përlligjen nga nevoja e mbrojtjes së interesit më të lartë të të miturit.”.

Neni 3

Shkronja “a”, e nenit 245, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) i është hequr përgjegjësia prindërore nga gjykata ose e ka humbur atë, sipas nenit 223, të këtij Kodi;”.

Neni 4

Neni 246 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 246 Pëlqimi për birësim

Për birësimin e të miturit kërkohet pëlqimi i të dy prindërve të tij, nëse ata njihen ligjërisht.

Pëlqimi për birësim nuk mund të jepet pa kaluar 8 javë nga lindja e të miturit.

Nëse prindërit e fëmijës janë të mitur, ata duhet ta japin vetë pëlqimin për birësim.

Në qoftë se njëri nga të dy prindërit ka vdekur, nuk është në gjendje të shprehë vullnetin e tij, i është hequr përgjegjësia prindërore ose ka humbur përgjegjësinë prindërore, pëlqimi i prindit tjetër është i mjaftueshëm. Pëlqimi i njërit prind është i mjaftueshëm edhe nëse prindi tjetër është i panjohur.

Kur fëmijës i kanë vdekur të dy prindërit, kur atyre u është hequr zotësia për të vepruar ose janë të panjohur, vendimi për birësimin e fëmijës merret nga gjykata.

Kur birësuesi është i martuar, duhet të merret pëlqimi i bashkëshortit të tij.

Kur i birësuari ka mbushur moshën dhjetë vjeç merret mendimi i tij dhe në moshën dymbëdhjetë vjeç kërkohet pëlqimi i tij.”.

Neni 5

Në nenin 247, shtohet paragrafi i dytë, me këtë përmbajtje:

“Rregullat e caktuara në paragrafin e parë, të këtij neni, për dhënien e pëlqimit përpara organeve përgjegjëse, zbatohen edhe për tërheqjen e pëlqimit për birësim.”.

Neni 6

Pas nenit 247 shtohet neni 247/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 247/1

Gjykata informon prindërit e të miturit mbi qëllimin, kushtet dhe pasojat ligjore që sjell dhënia e pëlqimit për birësim.

Para dhënies së pëlqimit, prindërve u ofrohet ndihmë ligjore dhe psikologjike nga punonjësit e njësisë së mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor, në një gjuhë të kuptueshme dhe të thjeshtë për atë.

Pëlqimi i prindërve për birësim merret vetëm pas informimit dhe ofrimit të këshillimit ligjor dhe psikologjik.”.

Neni 7

Neni 248 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 248

Prindërit biologjikë kanë të drejtë të tërheqin pëlqimin për birësim brenda 3 muajve nga çasti i dhënies së tij.

Prindërit biologjikë kanë të drejtë të tërheqin pëlqimin për birësim edhe pas kalimit të afatit 3-mujor nëse kërkojnë kthimin e të miturit, deri në çastin që i mituri nuk është vendosur nën përkujdesjen e një familjeje birësuese, me qëllim realizimin e periudhës së provës.

Nëse personi apo institucioni pranë të cilit është vendosur i mituri, refuzon kthimin e tij, prindërit biologjikë kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës kompetente, e cila duke marrë në konsideratë interesin më të lartë të të miturit, vendos pranimin ose jo të kërkesës për kthimin e të miturit. Pranimi i kërkesës sjell si pasojë revokimin e pëlqimit të prindit për birësim.

I mituri që ka mbushur moshën 12 vjeç ka të drejtë të tërheqë pëlqimin për birësim, deri në çastin e miratimit të birësimit nga gjykata.”.

Neni 8

Pas nenit 248 shtohet neni 248/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 248/1

Periudha e provës

Periudha e provës realizohet pas pëlqimit të dhënë nga Komiteti Shqiptar i Birësimeve, nëpërmjet vendosjes në përkujdesjen e familjes birësuese të të miturit për të cilin, prindërit kanë dhënë pëlqimin për birësim në gjykatë ose për birësimin e të cilit ka vendosur gjykata ose për të cilin është deklaruar braktisja nga gjykata.

Periudha e provës, e cila zgjat 3 muaj, shërben për të vendosur një marrëdhënie birësuese ndërmjet një të mituri dhe familjes birësuese.

Nëse prindërit e të miturit janë të panjohur, i mituri vendoset në periudhë prove vetëm pasi të kenë kaluar 3 muaj nga vendosja e tij në përkujdesje alternative pranë institucionit të përkujdesjes shoqërore, në zbatim të interesit më të lartë të të miturit.

I mituri nuk mund të vendoset në periudhë prove nëse prindërit kërkojnë kthimin e tij, derisa gjykata të marrë vendim për këtë çështje. Gjykata, përpara marrjes së vendimit, verifikon nëse janë plotësuar afatet e mësipërme dhe nëse kthimi i të miturit pranë prindërve biologjikë është në interesin më të lartë të të miturit.

Nëse i mituri vendoset në periudhë prove, prindërit e tij nuk mund të kërkojnë kthimin e të miturit.

Nëse periudha e provës ndërpritet ose gjykata refuzon birësimin, pasojat e periudhës së provës shuhen me efekt prapaveprues.”.

Neni 9

Neni 250 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 250 Deklarimi i braktisjes

Gjykata mund të deklarojë të braktisur të miturin që ndodhet pranë një institucioni të përkujdesjes shoqërore, publik ose privat, ose te personi që e ka në përkujdesje, kur prindërit e tij, përgjatë 1 viti, përpara paraqitjes së kërkesës për deklarimin e braktisjes, nuk kanë krijuar dhe ruajtur me të marrëdhëniet e nevojshme për edukimin ose zhvillimin e tij, me kusht që prindi të mos jetë penguar në krijimin dhe ruajtjen e këtyre marrëdhënieve, për shkaqe me rëndësi. Nuk konsiderohet se prindërit janë penguar në ruajtjen e këtyre marrëdhënieve, nëse refuzojnë masat mbështetëse të ofruara nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor dhe ky refuzim vlerësohet si i pajustificuar nga gjykata.

Kur i mituri është vendosur që nga lindja në një institucion, afati prej 1 viti reduktohet në 3 muaj dhe fillon nga data e lindjes.

Kur i mituri është gjetur i braktisur jashtë institucioneve të përkujdesjes shoqërore, publike ose jopublike, spitaleve apo materniteteve, publike ose private, afati prej 1 viti reduktohet në 3 muaj dhe fillon nga momenti i gjetjes së tij.

Kur i mituri është lënë nën kujdesin e institucioneve të përkujdesjes shoqërore, publike ose jopublike, përfshirë spitalet, publike ose jopublike, nëpërmjet një deklarate noteriale të prindërve biologjikë për dhënie e tij për birësim, afati prej një viti reduktohet në 3 muaj dhe fillon që nga momenti i lënies së të miturit.

Nuk përbëjnë akte të mjaftueshme për të refuzuar automatikisht kërkesën për deklarimin e braktisjes së të miturit, si dhe nuk sjellin ndërprerjen e afateve të përcaktuara në paragrafët e mësipërm të këtij neni:

- a) tërheqja e pëlqimit për birësim të dhënë në përputhje me parashikimin e paragrafit të pestë, të këtij neni;
- b) kërkesa për t’u informuar mbi gjendjen e të miturit;
- c) shprehja e qëllimit të prindërve ose të afërmeve të tjerë deri në shkallë të dytë, që kanë një marrëdhënie të qenësishme me fëmijën, për ta marrë fëmijën në përkujdesje, por që nuk pasohet nga marrja e tij në përkujdesje.”.

Neni 10

Neni 251 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 251

Kërkesa për, deklarin e braktisjes paraqitet në gjykatë nga drejtuesi i institucionit publik ose privat, ku ndodhet i mituri, nga personi që e ka në përkujdesje, ose nga njësia apo punonjësi i mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor, brenda 15 ditëve nga përfundimi i afateve të parashikuara në nenin 250, të këtij Kodi. Kërkesa mund të paraqitet edhe nga prokurori.

Kërkesa i dërgohet gjykatës nën juridiksionin e së cilës ndodhet institucioni ose vendbanimi i personit që e ka marrë në përkujdesje të miturin.

Çdo person që ka një interes të ligjshëm për mbrojtjen e të miturit mund të ndërhyjë në procesin e gjykimit.

Në gjykimin e deklarin të braktisjes, i mituri përfaqësohet nga një jurist ose avokat, që i sigurohet të miturit nga njësia e mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor.

Kërkesa për deklarin e braktisjes të të miturit paraqitet në gjykatë vetëm pasi njësia e mbrojtjes së fëmijës pranë pushtetit vendor, gjatë afateve të parashikuara në nenin 250, të këtij Kodi, u ka ofruar prindërve të fëmijës masat e duhura për përkrahje.

Gjykata i kërkon shpjegime personit që ka paraqitur kërkesën, nëse ka bërë përpjekje për gjetjen e prindërve biologjikë të të miturit dhe kthimin e të miturit në familjen biologjike, nëse kjo është e mundur. Këto përpjekje nuk janë të nevojshme në rastin kur i mituri është lënë nën kujdesin e institucioneve të përkujdesjes shoqërore, publike ose private, përfshirë spitalet, publike ose private, nëpërmjet një deklarate noteriale të prindërve biologjikë për dhënien e tij për birësim.

Gjykata nuk deklaron braktisjen e të miturit nëse, brenda afatit të parashikuar në nenin 250 të këtij Kodi, prindi ose një nga të afërmit deri në shkallë të dytë ka kërkuar marrjen e të miturit në përkujdesje dhe kjo kërkesë vlerësohet se është në interes të të miturit.

Braktisja e të miturit mund të deklarohet ndaj të dy prindërve ose vetëm njërit prej tyre.

Gjykata, që deklaron të braktisur të miturin, cakton në të njëjtin vendim edhe kujdestarin, një institucion të përkujdesjes shoqërore ose një person të caktuar, për mirërritjen, edukimin dhe arsimimin e të miturit, nisur nga interesi më i lartë i tij.

Kundër vendimit të gjykatës, palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankim në gjykatën e apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Shqyrtimi i ankimit bëhet brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të tij.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit, palët kanë të drejtë të ushtrojnë rekurs në Gjykatën e Lartë, brenda 30 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Shqyrtimi i rekursit bëhet brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të

tij.”.

Neni 11

Pas paragrafit të fundit, të nenit 254, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Gjykata merr vendim brenda 6 muajve nga paraqitja e kërkesës për birësim, pasi ka verifikuar përmbushjen e kushteve ligjore të birësimit dhe nëse ky birësim është në interesin më të lartë të të miturit.”.

Neni 12

Neni 256 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 256

Nëse përpara autoriteteve administrative ose gjyqësore janë duke u zhvilluar procedura për vërtetimin e amësisë apo të atësisë, të filluara nga nëna ose i ati i supozuar i fëmijës, procedura e birësimit pezullohet derisa të përfundojë procedura administrative ose gjyqësore për vërtetimin e amësisë apo të atësisë. Autoritetet administrative ose gjyqësore kanë detyrimin për të shqyrtuar me përparësi procedurat për vërtetimin e amësisë apo të atësisë, duke garantuar mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturit.”.

Neni 13

Neni 257 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 257

Ndalimet për birësimin ndërvendas

Birësimi ndërvendas nuk lejohet kur:

- a) birësimi nuk njihet në shtetin ku banojnë birësuesit;
- b) arrihet në përfundimin se birësimi sjell pasoja të rënda për të miturin;
- c) i mituri, në shtetin ku banojnë aplikantët birësues, nuk gëzon të njëjtat të drejta që i njihen në Shqipëri.

Birësimi ndërvendas lejohet vetëm pasi i mituri të ketë qëndruar 6 muaj në listat e pritjes së Komitetit Shqiptar të Birësimit dhe, gjatë kësaj periudhe, janë ezauruar të gjitha mundësitë për të bërë birësimin brenda vendit.

Pavarësisht nga parashikimi i paragrafit të dytë, të këtij neni, Komiteti Shqiptar i Birësimit, nisur nga interesi më i lartë i të miturit, me vendim të motivuar, mund të japë pëlqimin për birësimin e fëmijës jashtë vendit, dhe pa u përmbushur afati 6-mujor, nëse i mituri ndodhet në një nga rrethanat e mëposhtme:

- a) Shëndeti i të miturit mund të dëmtohet dhe ka nevojë për trajtime mjekësore të specializuara;
- b) I mituri është me aftësi të kufizuara intelektuale ose fizike, të vërtetuara nga komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) I mituri ka arritur një moshë që e bën të pamundur birësimin e tij brenda vendit;
- ç) I mituri ndodhet në rrethana të tjera të rënda sociale, familjare, psikologjike, emocionale, të cilat e vështirësojnë ose e bëjnë të pamundur birësimin e tij brenda vendit.”.

Neni 14

Pas nenit 260 shtohet neni 260/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 260/1

Vendimi i gjykatës transkriptohet në regjistrin e gjendjes civile të vendit të lindjes së të miturit të birësuar, brenda 15 ditëve nga momenti i marrjes së formës së prerë. Elementet e vendimit që transkriptohen janë:

- a) dita, ora dhe vendi i lindjes së të miturit;
- b) gjinia e të miturit;
- c) emri dhe mbiemri i të miturit që rezultojnë nga vendimi gjyqësor;
- ç) të dhënat e birësuesve: emri, mbiemri, data dhe vendi i lindjes, profesioni dhe vendbanimi i tyre.

Ky transkriptim nuk përmban asnjë të dhënë për prindërit biologjikë të të miturit. Transkriptimi zëvendëson aktin e lindjes së të miturit. Në aktin fillestar të lindjes së të miturit shënohet “birësim” dhe ky akt shfuqizohet.”.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI